



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1383/ prot.
7

Tiranë më 17.12.2020

REKOMANDIM

Nr. 27, datë 17.12.2020

**PËR KONTROLLUESIN “ALBANIA MARKETING SERVICE SHPK -
TELEPERFORMANCE”**

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), në ngarkim të kontrolluesit “Albania Marketing Service SHPK – Teleperformance” (në vijim, “Kontrolluesi”),

KONSTATOVA SE:

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) ka marrë në shqyrtim ankesën e Sindikatës së Solidaritetit (në vijim, “Ankuesi”), në lidhje me mbikëqyrjen e punonjësve të cilët punojnë në distancë, nëpërmjet kamerave të instaluar në kompjuterin e punës (në shtëpi).

Në kuadër të zgjidhjes së ankesës, Zyra e Komisionerit me shkresën nr. 1383/2 Prot., datë 12.11.2020 ka kërkuar nga kontrolluesi informacion dhe sqarime në lidhje me pretendimet e ankuesit, si dhe ka bërë me dije detyrimet që burojnë nga dispozitat e ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar (në vijim, “Ligji”).

Në përgjigje të kërkesës së Zyrës së Komisionerit, me shkresën datë 20.11.2020, administruar me nr. 1383/3 prot., datë 23.11.2020, kontrolluesi ka sqaruar se, për shkak të gjendjes së krijuar nga pandemia Covid 19, janë marrë masa për organizimin e përkohshëm të punës në distancë (nga ambientet e shtëpisë). Për të arritur këtë qëllim, kontrolluesi ka vendosur të përpunojë të dhënat e punëmarrësve edhe nëpërmjet kamerave të vëzhgimit CCTV, të cilat do të instalohen në kompjuterin e punës.

Me qëllim zgjidhjen sa më të drejtë të çështjes, në bazë të neneve 87 - 89 të Kodit të Procedurave Administrative, përpara marrjes së vendimit përfundimtar, u zhvillua seancë dëgjimore, në të cilën morën pjesë përfaqësues të kontrolluesit dhe ankuesit.

Pas analizimit të pretendimeve dhe provave të paraqitura nga palët, Zyra e Komisionerit vlerëson se, në lidhje me monitorimin e punonjësve, çdo kontrollues duhet të marrë në konsideratë paraprakisht disa kriterë ligjore përpara fillimit të procesit të përpunimit të të dhënave personale.

Në bazë të Ligjit, çdo përpunim i të dhënave personale duhet të ketë një qëllim specifik, të qartë dhe të ligjshëm. Një qëllim i ligjshëm për monitorimin e punonjësve mund të jetë, për shembull, ruajtja e sigurisë së të dhënave personale kur punonjësit punojnë në distancë, sigurimi i respektimit të detyrimeve ligjore ose për të garantuar që një punonjës është duke kryer detyrimet e tij sipas një kontrate pune.

Pasi të jetë identifikuar qartë qëllimi i ligjshëm i përpunimit, punëdhënësi duhet të sigurojë që çdo e dhënë personale e mbledhur për këtë qëllim të përpunohet vetëm për atë që është e nevojshme për atë qëllim specifik, në përputhje me parimin e kufizimit të qëllimit të parashikuar në nenin 5 të Ligjit. Çelësi i kësaj procedure do të jetë garantimi që monitorimi i propozuar nga punëdhënësi, të jetë brenda pritshmërive të arsyeshme të punonjësve.

Punëdhënësit që monitorojnë duhet të respektojnë parimin e mjaftueshmërisë së të dhënave sipas parashikimit të germës “c” të pikës 1 të nenit 5 të Ligjit “*Të dhënat personale mund të mbledhen vetëm nëse është e nevojshme për të arritur një qëllim specifik dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim*”. Për ta vërtetuar këtë, do të duhet të vlerësojnë nëse mbledhja e të dhënave personale të punonjësve është proporcionale me qëllimin. Në këtë këndvështrim, nga punëdhënësi duhet të vlerësohet nëse ekziston një mënyrë tjetër më pak ndërhyrëse në jetën private në të cilën të njëjtat rezultate mund të arrihen.

Nga kontrolluesi, përveç të tjerash, janë paraqitur për legjitimitimin e procesit, aktet në lidhje me informimin dhe marrjen e pëlqimit të punëmarrësve.

Duke ju referuar parashikimeve të ligjit, Zyra e Komisionerit vlerëson se nuk është e mundur që punëdhënësi të mbështetet vetëm në pëlqimin e punonjësve si bazën ligjore mbi të cilën përpunojnë të dhënat personale të tyre, për shkak të çekuilibrit eventual të “pushtetit” në marrëdhëniet midis punëdhënësit dhe punëmarrësit, gjë që e bën të vështirë të provohet se pëlqimi është dhënë lirisht. Në bazë të pikës 24 të nenit 3 të Ligjit “*Pëlqimi i subjekteve të të dhënave*” është çdo deklaratë me shkrim, e dhënë shprehimisht me vullnet të plotë e të lirë dhe duke qenë në dijeni të plotë për arsyen pse të dhënat do të përpunohen, çka nënkupton që subjekti i të dhënave pranon që të përpunohen të dhënat e tij”.

Baza e duhur ligjore në fund të fundit do të varet nga situata specifike, por bazat potencialisht relevante ligjore mund të jenë, kur përpunimi i të dhënave personale përmes monitorimit është i domosdoshëm për kryerjen e kontratës së punës, ose është i nevojshëm për respektimin e një detyrimi ligjor të cilit i nënshtrohet punëdhënësi, ose është i nevojshëm për qëllime të interesave legjitime të punëdhënësit (kur kjo nuk rrëzohet nga të drejtat dhe liritë themelore të punonjësve). Pra, të zbatohet një nga kriteret e ligjshme të përpunimit të përcaktuara në nenin 6 të Ligjit.

Për të garantuar minimizimin e rreziqeve të mundshme për cenimin e privatësisë, nëpërmjet monitorimit të punonjësve, duhet të kryhej paraprakisht një vlerësim i ndikimit në mbrojtjen e të dhënave, në rastet kur përpunimi mund të sjellë një rrezik të lartë për të drejtat dhe liritë e individit. Monitorimi i punonjësve arrin këtë limit, veçanërisht kur ka monitorim sistematik, kur përdoren teknologji të reja, ose po kryhet një vlerësim bazuar në monitorimin e punonjësve.

Sa më sipër, Zyra e Komisionerit, duke ju referuar akteve dhe deklarimeve të depozituara nga Kontrolluesi, vlerëson disa nga masat e ndërmarra nga ky i fundit në kuadër të këtij procesi përpunues në tërësi. Megjithatë, duke ju referuar përpunimit të të dhënave personale nëpërmjet sistemit të video survejimit (CCTV), vlerëson se për një pjesë të procesit përpunues mund të mos legjitimohet përpunimi i të dhënave.

Në aneksin e kontratës së punës e cila është hartuar nga kontrolluesi për këtë proces përpunues të të dhënave, qëllimi i vendosjes së kamerave është parashikuar të jetë *“për arsye të komunikimit me Supervizorin si dhe mundësinë e verifikimit që shërbimi ofrohet në kushte të kërkuara dhe paracaktuara nga punëdhënësi”*.

Lidhur me qëllimin për arsye të komunikimit me Supervizorin, Zyra e Komisionerit vlerëson se është kompetencë e Kontrolluesit të përcaktojë qëllimin dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave, në funksion të veprimtarisë së tij, duke respektuar parashikimet e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Lidhur me qëllimin e verifikimit të shërbimit, Zyra e Komisionerit vlerëson se kamera e vëzhgimit nuk mund të përdoret për mbikëqyrjen e një punonjësi në vendin e punës, vendosja e kamerave në ambientet e punës së punonjësve (zyrë apo shtëpi me qëllim mbikëqyrjen) është në kundërshtim me parashikimet e ligjit dhe akteve nënligjore, konkretisht Udhëzimit nr. 11, datë 08.09.2011, të Komisionerit mbi *“Përpunimin e të dhënave personale të punonjësve në sektorin privat”* i ndryshuar.

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit vlerëson se është përgjegjësi e Kontrolluesit për të marrë masat e nevojshme teknike dhe organizative të përshtatshme për të mbrojtur aksesin ose përhapjen e të dhënave nga persona të paautorizuar, për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, humbje aksidentale, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, sipas parashikimit në nenin 27 të Ligjit.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 6, 21, 27, 29, 30, 31 (pika 1, gërma “a/l”), si dhe 32 të Ligjit,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi të marrë masa për bllokimin e përpunimit të të dhënave për qëllimin e verifikimit të shërbimit të punëmarrësve në kushte të kërkuara dhe paracaktuara prej tij;

2. Kontrolluesi të ketë në vëmendje të vazhdueshme përpunimin e të dhënave personale në përputhje me dispozitat e parashikuara në nenin 5 të Ligjit, si dhe të marrë masa për adresimin e konstatimeve të Komisionerit;
3. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 21 të Ligjit, të përditësojë njoftimin për ndryshimin e gjendjes së përpunimit, sipas parashikimit në nenin 22 të Ligjit, të njoftuar më parë;
4. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, të ketë në vëmendje masat e sigurisë në drejtim të garantimit të procesit përpunimit të të dhënave për të mbrojtur aksesin ose përhapjen e të dhënave të personave të paautorizuar;
5. Në zbatim të pikës 1, të nenit 32, të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti brenda afateve si vijon:
 - (i) menjëherë, detyrimin e parashikuar në pikën 1 më sipër;
 - (ii) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimin e parashikuar në pikën 3 më sipër;
6. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra.

Në rast mospërmbushjeje të detyrimeve të parashikuara në këtë akt, Komisioneri vepron sipas pikës 2 të nenit 30 dhe nenit 39 të Ligjit, të cilët parashikojnë se në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të Ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, Komisioneri vendos sanksione administrative për kundërvajtjet administrative përkatëse dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot, më datë 17.12.2020

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

